



# KUVENDI KOMUNAL - DEÇAN

Municipal Assembly of Decan

## TRANSKRIPTI

DEÇANI

**Mbledhjen e Kuvendit të Komunës**

**(Legjislatura e VII , mbledhja e IV) me dt.30.05.2025**



DEÇAN

**e Premte, 30 Maj 2024**

## Hajdar Sutaj

Përsëritet për gjithë, a ka ndonjë nga kolegë që nuk është nënshkruar në listë, ju kisha lutur kolegë nëse është dikush që nuk është nënshkruar në listë ju kisha lutur me ardh dhe me nënshkruar.

Të nderuar kolegë, kam kënaqësinë që me hap mbledhjen e radhës së Kuvendit Komunal, fillimisht më lejoni që të ju njoftoj që nga 27 anëtarët të Kuvendit, 20 janë prezent pra ka kurum të mjaftueshëm me vazhdu me punimet e seancës së Kuvendit, fillimisht ashtu siç e keni marrë dhe materialin më lejoni të prezantoj para jush rendin e punës i cili është shpropozuar për këtë seance.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i process verbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Shqyrtimi i raportit të Këshillit të Veprimit Rinor Lokal, KVRL.
3. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të Jashtëm të npl Higjena.
4. Shqyrtimi i propozim vendimit për pagesën e kryetarëve të këshillave të fshatrave edhe të ndryshmet do ti propozoj tash për rend dite, futen në rend dite dy propozime, për... shpalljen qytetar nderi të komunës së Deçanit Kolonel Todd Jacobs edhe po ashtu të zotit Marian Mema, i cili është propozuar nga Shoqata e Historianëve Ali Hadri në Deçan.

A keni diçka në lidhje me rendin e ditës?

Miftar Ahmetxhekaj e ka kërku fjalën kolegë nëse mundeni mbani qetësi kush don me fol mundemi me e shfrytzu hapësirën jashtë salle faleminderit shumë respect.

## Miftar Ahmetxhekaj

Faleminderit shumë kryesus përsëritet për të gjithë këshilltar komunal, unë i kam dy çështe se disa vlerësohen si pjesë, por vlerësoj që duhet të jenë të rendit të ditës e para ka të bëjë kryesus me transmetimin e seancave që po bëhet e më saktësisht e lidhur me... unë po e thomë me mos transmetimin e seancës së kaluar, unë e di që ky medium e ka ni marrëveshje dhe ky medium paguhet prej taksave të qytetarëve unë nuk kam ndonjë mekanizëm që duhet të hy në ndonjë faqen YouTube ku ta di unë.

Unë e di që ky transmetim nuk është në webfaqen zyrtare, nuk është shfaqë edhe e dyta ka të bëjë me transkriptet e seancës së kaluar më duket që është seanca e dytë që po na përsëritet e njëjtja domethënë na vinë ni seancë paraprake mirë është besoj që është kohë e mjaftueshme për sekretarin që të përgatitet që seancën e fundit ta paraqesha transkriptin e seancës së rradhës, që mos ti përtyrim kështu transkriptet faleminderit shumë.

## Hajdar Sutaj

Faleminderit Miftar janë shqetësime dhe vërejtje shumë me vend këto vërejtje janë përcjell personalisht edhe nëpërmjet zyrës për informim, menaxherës të kësaj kontrate, e cila nuk po shoh që është sot present e shpresoj që ja përcjell edhe mediumit në fjalë, sepse i kam ngrit shqetësimet e mia për disa deshtime të një pasnjëshme disa raste edhe pse ato realisht janë postu në YouTube po megjithatë duhet me qenë edhe në faqen zyrtare të komunës në Facebook transmetimi bëhet live.

Sa i përket transkripteve po e vërtetë po ashtu në seancën që vjen i kemi të dyjat edhe këta edhe këta të fundit edhe këta të para fundit si duket ka qenë një situatë ndoshta jo mirë e sqaruar për mirëmbajtjen e transkriptit edhe tash kanë bërë ni marrëveshje për atë programin i cili e bën ajo pastaj ka qenë vetëm për dy vjet edhe pse pajisja është po ai programi që i përkthen sa i përket rendit të ditës a keni diçka, Orges Tafilaj e ka fjalën

## Orges Tafilaj

Faleminderit kryesus përsëritet për të gjithë mu ndërlidh me Miftarin besoj që është e udhës që pika një të ndryshohet edhe të thuhet shqyrtimi dhe miratimi i transkriptit, jo nga mbledhja e kaluar, po nga mbledhja e datës 28 mars në mënyrë që pas votimit të kalojë në rregull.

## Hajdar Sutaj

Faleminderit propozim i qëlluar, dikush tjetër Vatan Istrefaj.

## Vatan Istrefaj

Faleminderit për fjalën kryesur përshëndetje për të gjithë, së pari kam një propozim pasi që ne ora 11 është që të bëjmë homazhe në qendër të Deçanit tek lapidari do të ishte mirë që të merrnim leje 20 minuta që të jemi edhe ne prezenta aty si asamble, e dyta kryesur ti ki kontakt me kryetarin të vazhdueshëm a mund të na japësh ndonje aryse pse nuk është këtu me ne, apo është bërë krejt normale mos me ardhë në séance faleminderit.

## Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë kryetari për pakë na bashkohet ndërsa sa i përket homazheve, po e kemi pas të planifikume që të paktën varësisht si është rrjedha e Kuvendit po para praktikisht do të marrim pauzë dhe ti bashkohemi homazheve në nderim dhe përkujtim dëshmorëve të qytetit të Deçanit e qesë në votim rendin e dites me propozimet të cilat I thash edhe me rekomandimet që I dha edhe Orgesi.

Kush është për?

A ka kundër?

A ka Abstenim?

Sa I persket proces verbalit të dates 28 mars a ka dikush diqka me diskutu

Kush është për?

A ka kundër?

A ka abstenim?

Konstatoj që kuvendi në mënyr anonime e ka miratuar process verbalin e dates 28 mars.

Jemi te pika e dytë shqyrtimi I raportit të këshillit veprimit rinor lokal KvrL, e kemi këtu prezent edhe kryetarin e KvrL-s zotri Mushkolaj të cilit fillimisht ja kaloj fjalën, zotri Mushkolaj fjala për ju mundësisht shfrytëzonte foltoren.

## En Mushkolaj

I nderuar Kryesur të nderuar asambleistë dhe të nderuar të gjithë të pranishmit!

Unë jam En Mushkollaj, kryetar i Këshillit Rinor Veprues Lokal të Komunës së Deçanit sot do të bejë prezantimin e raportit të planit të KRVL-së, ku si fillim aj është themelu qysh nga viti i kaluar dhe është objekti ma i lartë i përfaqësimit të rinjve në subjektin e komunës së Deçanit, veprimi i saj është i shtrim në avokimin për rini, lobimin për rini, kulturë edhe rini e sport, ajo vepron në bazë të statutit të saj, në cilin është i themelum, aktin themelor dhe është e regjistruar si një Ojq.

Këshilli Rinor Veprues Lokal i komunës së Deçanit është i përbërë prej kryetarit, nën-kryetarit, tre sekretarë, një arkatar dhe pesë delegat, të cilët janë të përzgjedhur nga Gjimnazi i komunës së Deçanit, atëherë tek raporti e kam përfshi pjesën gjashtë mujore të punës, ku objektivat kryesore që nga fillimi i Këshillit Rinor Veprues Lokal kanë qenë fuqizimi i të rinjve në vendim marrje dhe shoqëri, ndërgjegjesimi i të rinjve për çështje të rëndësishme shoqërore dhe mjedisore, zhvillimi i kapaciteteve te të rinjve përmes trajnimeve dhe punëtorive, nxitja e aktivizimit rinor dhe vullnetarizmit në komunitet dhe zhvillimi i partneriteteve strategjike me organizata dhe institucione relevante.

Çka kemi rritë ne si KRVL që prej fillimit të saj e deri sot, atëherë është bashkëpunim me shumicën e Ojq-ëve si në Deçan, ashtu edhe jashtë Deçanit aktivitetet kryesore dhe arritjet kryesore siç i kam përmend në raportin e punës, janë aktivitete mjedisore dhe ndërgjegjësuese ku është organizimi i aktiviteteve në terren për pastrimin e hapësira publike dhe sensibilizimin për ruajtjen e mjedisit, fushata ndërgjegjësuese për ekomjedisin edhe edukimin ambiental në shkolla, pika tjetër është ndërgjegjesimi dhe fuqizimi i të rinjve, ku është bo realizimi i aktiviteteve për vetëdijesim dhe përfshirjes rinore në vendimmarrje në mbajtje të diskutimeve tematike mbi sfidat e të rinjve, pikë tjetër kemi aktivitete sportive dhe sociale, organizimi i aktiviteteve sportive për të rinjtë, përfshirja e grupeve të ndryshme të të rinjve për ndërtimin e një komuniteti gjithëpërfshirës. E kemi dhe zhvillimin e kapaciteteve dhe trajnimeve, ku prej fillimit të saj ka pasur trajnime që janë mbajtur me OSBE-në dhe me organizata të tjera që kanë ndihmu në trajnimin e anëtarëve të KRVL-së.

Kemi pas certifikimin e anëtarëve të KRVL-së si fasilitator ose trajner, pjesmarrja në trajnimet e OSBE-së dhe organizatat e tjera partnere, pjesmarrja në punëtori dhe forume kombëtare, përforcimi i zërit të të rinjve, Forumi i Shoqërisë Civile, Punëtorja për Zhvillimin e Projekteve dhe Propozime Buxhetore, Trajnimi, Advokaci and Partnership Building. Gjithashtu kemi realizu bashkëpunime dhe partneri tjetër me OSBE, Activism Roots dhe organizata të tjera lokale. Kemi bo rrjedhizimin dhe përfaqsimin në ngjarje të nivelit kombëtar.

Rezultatet kryesore që ne i kemi arritë është rritja e përfshirjes së të rinjve në aktivitete komunale edhe civile, krijimi i një bërthame të qëndrueshme të të rinjve të trajnuar dhe të certifikuar forcimi i bashkëpunimit me

organizata partnere dhe ndikimi konkret në përmirësimin e mjedisit, ndërgjegjesimin e komunitetit lokal si dhe ndërgjegjesimin e të rinjve të kësaj komune. Prej fillimit të KRVL-së, një aleat ose partner kryesor i saj ka qenë edhe ShF (....) ku në bazë statistika policore, së bashku me të, ajo ka arritur që në vitin 2024-2025 me sjellë rreth 40.000 turistë, kur nuk kanë qenë vetëm prej Kosovës e Deçanit, po edhe prej Shqipërie, Mali zi dhe vendeve të tjera. Në një pjesë tjetër e kemi edhe sallat e qendrës rinore, ku kryesisht ato të cilat kanë qenë për trajnime, konferenca, seminare, promovime, treza shkencore dhe aktivitetet e tjera kanë qenë papages për shfrytëzimin e këtyre sallave të hapësirave të Qendrës rinore. Pjesëmarrja nëpër të gjitha aktivitetet të kulturore të trinisë, sportit në mënyrë, në mënyrë vullnetare ka qenë e KRVL-s, ku kanë marrë pjesë të gjithë anëtarët e KRVL-s çdo aktivitet që ka ndodhur. Trajnimet e KRVL-s derisa qendra jonë nuk ka qenë funksionale, janë mbajtur në sallat e komunës dhe në hapësira apo vende të tjera, ku kanë pasur mundësi me i gjet. Pas funksionalizimit të qendrës rinore, çdo salë ka qenë funksionale për përdorimin e KRVL-s dhe Ojq-ve të tjera, të cilat kanë pasur nevojë për realizimin e aktiviteteve, trajnimeve apo takimeve me të rinjtë dhe sidoqoftë me synim të tyre. Qendra Rinore është e pajisur me të gjitha gjërat e nevojshme është hapur për përdorim jo vetëm prej KRVL-s por prej çdo individi tjetër, KRVL-ja gjithashtu ka edhe një zyrë për punën e saj dhe funksionalizimin e saj në Qendrën Rinore. Pas formimit të saj, KRVL-ja takimin e parë e ka mbajtur me të gjithë përfaqësuesit e partive politike rinore, ku osht diskutu se çfarë duhet të bëjmë për trit e kësaj komune dhe pikat kryesore si ne çka duhet me ndërmarr se KRVL-së bashku me ata. Gjithashtu është edhe bifeja e Qendrës Rinore, e cila vlen për tu cekur që është e menaxhime prej Këshillit Rinor veprues lokal, ku një anëtar i Këshillit Rinor në bazë të statutit, paguhet nga të hyrat e bifesë të gjitha pajisjet e nevojshme të Këshillit Rinor veprues lokal, siç janë terrasa, shiltet, këndi I të rinjëve dhe pajisjet e tjera janë financuara nga SHB Mariashi dhe çdo nevojë tjetër e Këshillit Rinor qysh prej fillimit të saj ka qenë e mbështetur prej SHB Mariashit përveç aktivitetëve që KRVL-ja ka qenë çdo herë pj-- çdo herë pjesëmarrëse, atëherë vlen të thekët që pi-- tani KRVL-s osht edhe pjesë e Komisionit për hartimit e planit për Kulturë, Rini edhe Sport. Në katërvjeçarin e mandatit të ardhshëm. Gjithashtu, KRVL-ja përveç që ka mbajtur trajnime e takime me të rinjtë e komunës së Deçanit, ajo ka filluar me mbajtur trajnime dhe takime me nxënësit e gjimnazëve, ku është vazhdimisht duke mbajtur me ta takime për informimin e KRVL-s-të, aktiviteteve, ftesë për bashkëngjitje dhe prezantimin e Qendrës Rinore. Kemi pasur edhe periudha të caktuara dhe pauza për shkak të angazhi-- angazhimit shkollor për shkollën, ku kanë qenë përfundimet e semestrave. Gjatë realizimit të gjithë këtu aktiviteteve, KRVL-ja ka pasur edhe disa sfida të cilat i janë hasë mirëpo në bazë të Kryetarit të Komunës së Deçanit, Asambleistëve dhe kryesisht SHB Mariashit, atëherë ka arrit me i përfundu projektet e saj. Ka pasur në fillim më shumë nevoja për hapësira. Po me funksionalizimin e Qendrës Rinore, hapësirat e dedikuara për aktivitetet rinore janë realizu edhe ka pasur mungesë pjesëmarrjes së të rinjve për shkak të informacionit. Ku në anë të informacionit për shkollë nëpër gjimnaza dhe rrjetet sociale janë informu për qendrën rinore dhe veprimin e Këshillit Rinor të komunës së Deçanit. Ne si KRVL-s për periudhën e ardhshme kemi pasur disa rekomandime, ku me pas më shumë mbështetje financiare dhe logjistike nga komunat dhe partnerë. Zgjerimi i rrjetit bashkëpunimeve. Bashkëpunim i ngushtë me shkollat përpërfshirjen e nxënësve dhe krijimi i një platforme dixhitale për promovimin e aktiviteteve, punës së Këshillit Rinor dhe komunikimit me të rinjtë. Ju faleminderit!

### **Hajdar Sutaj**

Faleminderit mundesh me u ulë të përgëzoj për punën edhe për raportin të falenderoj edhe për prezencën dhe për paraqitjen e tash sipas rregullit fillimisht në emër të subjekteve politike, zotri Arian Dobraj nga grupi I Aleancë për Ardhmërin e Kosovës e ka fjalën

### **Arjan Dobraj**

Faleminderit kryesus i nderuar kryetar, të nderuar kolegë dhe drejtorët e drejtorive. Faktikisht deshta së pari ta përgëzoj Enin për shtjellimin e raportit të punës interesante ke pjesa që kanë pas aktivitetesh shumë mua më intereso me ditë pak ma gjërësisht realisht për aktivitetet të cilat janë mbajtur që i përmendni vazhdimisht aktivitetet, trajnime po nuk nuk na dha një raport pak më të detajum ishte për tu vlerësuar shumë pjesa, sepse po dëgjojmë fjalët e kohet fundit që pse jo nuk po shfrytëzohet mjaftueshëm qendra rinore nga të rinjtë është për tu pershendetur edhe puna e Kryetarit Ramosaj për shkak të shfrytëzimit papages të sallave ose ambienteve të Qendrës Rinore, të cilin e përgëzojm edhe e falënderojmë për këtë pjesë kryetarin. Te pjesa tjetër deshta me pyet Enin, kur e patë fjalën për bërjen e kryesisë së Këshillit Rinor Lokal, se e përmendi vetëm Gjimnazin "Vllëzërit Frashi", a janë kryesia KRVL-së vetëm nxënësit nga gjimnazi apo janë pjesë edhe nga IAP-të Tafil Kasumaj? ndersa tjetra kur përmendni rezultatet kryesore nuk patem të dhena përmes ndonjë statistike, për me e ditë pak më detajisht se për çka bohet fjalë, ose me cilat organizata

bashkëpunojnë përpos OSBE-së. Si dhe te raporti i cili është dasht të vijë të ma herët, te pjesa e rekomandimeve kisha dasht me qenë pak më i qartë se çka kërkohet, se qfar mund të japim ne si Asambleistë kontributin tonë për realizimin e projekteve që kanë si synim për periudhën e ardhshme faleminderit.

### Hajdar Sutaj

Faleminderit Arian kryetar En ti ki mundësi mu përgjigj pasë çdo diskutuese ose në fund qysh po don... në rregull fjala për ty, a ke mundësi me shfrytëzu foltoren për shkak edhe të transkriptit.

### En Mushkolaj

Atëherë faleminderit për pyetjen tek pjesa aktiviteteve KRVL-ja qysh prej fillimit të saj, ajo ka fillu në themelim aktivitet kryesore në fillim të KRVL-s kan qenë për vetëdijësimin e të rinjve të kësaj komune, ku ka qenë zhvillimi i socializimit të të rinjve ka marrë pjesë nëpër aktivitete dhe trajnime prej Ambasadës Franceze ku pikë kryesore ka qenë trajnimet mbi mjedisin dhe ekomjedisin që i ka vedisuar ata se çka duhet me bo me mjedisin tonë dhe se si ne mundem me ndihmu ato, që me ec ma përpara dhe me mbrojtë mjedisin tonë. Pjesë tjetër ka qenë edhe vedisimi i tyre me lubu për drejtën e tyre dhe çka ata duhet me bo edhe çfarë vendi edhe çfarë roli lujnë në secilin komunë edhe në secilin subjekt që ata gjenden. Pjesë tjetër të aktiviteteve ka qenë edhe me aktivizëm (...) që e kom cek edhe në raport përveç këtyre kemi bashkëpunu edhe me Ojq që kanë qenë jashtë Deçanit, si kanë qenë Këshilli Rinor Veprues Lokal i Komunës së Gjakovës, Pejës dhe te Istogut. Atëhere tek pjesa e rekomandimeve, rekomandimet që nevojiten prej Asambleistëve është që me vetëdijësu ma shumë të rinjr prej fshatrave apo prej vendëve që ata i përfaqësojnë, në Qendrën Rinore dhe në Këshillin Rinor Veprues Lokal, që ata ma shume me pas qasje në qendra rinore, me u informu se çfarë shërben qendra rinore aty edhe këshilli rinor, me bashkëpunu me neve që na mi paraqit edhe kërkesat e tyre, dhe ankesat e tyre qka kanë tek subjektet politike të komunës së Deçanit, faleminderit.

### Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë e pate edhe një pyetje ne lidhje me perberjen e kryesis

### En Mushkolaj

Perberja e Kryesisë të Këshilli Rinor Veprues Lokal të Komunës së Deçanit kur u themelua, ka qenë përbërë prej kryesisë të dy gjimnazeve edhe prej ati Teknik edhe prej Vëllezërve Frashëri të komunës së Deçanit po pasi që ata kanë kalu në fakultete, atëhere prej asnjërit gjimnaz nuk janë më kryesia, vetëm që e paraqesin domethënë rininë e krejt komunës së Deçanit.

### Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë nga Ldk-ja... En mundsisht ulu ose që don eja ulu këtu afër, Vatan Istrefaj e ka fjalën.

### Vatan Istrefaj

Faleminderit për fjalën kryesus faleminderit Eni që je këtu sot me ne dhe faleminderit për prezantimin. Me disa tema që ti i shtjellove pajtohem plotësisht por me disa tjera jo kur flasim për KRVL-n ose për Planin Rinor të Veprimit Lokal, të gjithë e din këtu se si anëtar i Kuvendit Komunal kam qenë shumë idhtarë i themelimit të KRVL-s, pasi që në një periudh të gjat në Deçan nuk ka patur KRVL funksionale dhe jam përpjekur që edhe ekzekutivi komunale dhe kryetari të sigurojë fondet dhe te ju suportoj edhe financiarisht kurse sot pasi analizova ket raport të punës nuk ndihem ashtu te themi mirë sepse nuk më përputhet raporti i punës me punët që janë parë edhe me punët që kam përcjellur unë edhe përmes rrjetëve sociale. Nëse e shohim edhe rrjetet sociale të KRVL-s në Deçan, atëhere aty duhet të pasqyrohet çdo punë ose çdo aktivitet që ju e keni bërë, pasi që këto aktivitete janë publike dhe nëse shohim faqen juaj zyrtare aty shohim që i keni komplet (....) pastime ku prej (....) postimeve, pesë jon si të themi aktivitete më serioze siq janë takimet, trajnimet etjera për rininë, ku kemi qenë edhe ne pjesë e njëjtë prej këtyre aktiviteteve. 5 prej tyre pastaj janë thirrur publike për parti edhe për të shikuar futbol në Qendrën Rinore, që nuk kanë ndonjë domethënie të madhe përpos socializimit të të rinjeve aty dhe pjesa tjerë janë aktivitete që nuk i përkasin shumë rinis, por janë aktivitete të përgjithshme, kështu postime për ndonjë festë ose diçka tjetër. Por nuk po mendoj se ju keni permbajtur

shumë këshillit veprimit rrinor lokal në Deçan, apo tv planit kurse ne raport janë cekur si pershembull ndërgjegjësimi, fuqizimi i trinjeve, aktivitete sportive sociale e kështu me radhë pastaj tek objektivat, i keni cekur objektivat siç janë në raport, por për mendimin tim nuk janë shumë reale pasi qe ne planin e veprimit rrinor lokal është cekur, të cilin plan e kemi miratuar edhe ne këtu në kuvend. Thuhet që KRVL-ja duhet të patur motivimin e të rinjeve për biblioteka, sepse nuk e kemi parë shpesh herë. Organizimin e kursëve periodike në fusha ndryshme nuk e kemi parë asnjëherë. Aktivizimi i kampeve rinore nëpër vendet rurale s'e kemi parë asnjëherë, javat e të rinjeve të bashkëdhjetarëve personalisht se kam pare por kjo për mua ndoshta merr kuptim, pasi që kur e shoh tek sfidat e hasura që e keni cekur ju vetë aty, e shoh që keni cekur vështirësim financiar në projektet për shkak të mungesës së fondeve apo mungesës financiare kështu që domethënë për ti kryer këto aktivitete, unë kuptoj është dashur të pashë mbështetje financiare, e kete faj un ja le vetem komunes ose kryetarit. Lutja ime për ty Eni është që të jesh aktivë ma shumë, të lypësh fondet për organizatat tjera, nëse komuna veç nuk e gjen atë fushë të dëshirueshme. Po ashtu, një lutje kryesore kam për kryetarin sa i përket qendrës rinore dhe... suportimit te këtij grupi pra, të KRVL-s financiarisht kërkoj qendra rinore kryetar, që ti përkasë një organizatë rinore.

### Hajdar Sutaj

A keni mundesi me vazhdu fjalën te Vatani

### Vatan Istrefaj

Faleminderit përpos financimit kryetar kisha kërku që qendra rinore të menaxhohet dhe të jetë komplet e KRVL-s aty, në një përqindje masive, dhe të menaxhohet nga organizatat jo qeveritare rinore, e jo të përdoret nganjëherë edhe nga militant partiake, per ndeja me qitelia mish e birra, kështu që nuk na shërben as mu, as ty, as qytetarëve faleminderit bile ti nuk bene te jesh present ne asi gjera hiq

### Hajdar Sutaj

Kryetari Eni Mushkulaj e ka fjalën.

### En Mushkolaj

Për aktivitete që kanë mbajtur KRVL-ja ti ke gjetë aktivitetet vetem që janë mbajtur në rrjetin social që janë postuar n'Facebook. Tek Instagrami, aktivitete që janë mbajtur, nuk mundesh me gjetur për arsye se faqja e Instagrami të KRVL-s është e mbyllur përkohësisht pjesa tjetër të java e të rinve atdhetarë ka qenë e mbajtur ne qendrën rinore e cila është postuar edhe ka qenë e publikume që me qenë pjemarrja aty Atëhere unë po e përfundoj për informim ata që them. Pjesa tjetër të aktiviteteve që ti po thua nuk janë mbajtur, krejt çka ti ke përmend, janë mbajtur për arsye se shumica e aktiviteteve nuk janë të postuara ne kemi bo punën, thirrjet janë bërë janë dërguar neper gjimnaze neper emaila dhe kan ardhur të rinjët kan qenë pjesëmarrës ne shumicën e aktiviteteve edhe shumica e planit veprimit rinor qe është kan e parapame është permbush, tek financimi plani I veprimit e ka pasur qe financimin me be bashkë me komunën mirëpo komuna nuk ka pasur buxhet të mjaftushum për aktivitetet tjera që ka qen e nevojshme me ndihmu edhe organizatat e tjera ku një prej ndihmesav kryesore ka qen SHB Mariashi e përmenda më herët që ka ndihmuar në financim dhe pjesa tjetër ka qen prej OSBE-s ku ka ndihmuar edhe në themelimin e saj.

### Hajdar Sutaj

Faleminderit kryetari En, nga Vetëvendosja Teuta Neziraj e ka fjalën

### Teuta Neziraj

I nderuar kryetar I nderuar kryesus te nderuar drejtor dhe ju kolegë asambleist, Eni po ma vjen mir qe po te shoh që je I paranishëm këtu në mesin tonë fillimisht dua te jap pak përkrahje me u ndi shilir se ne nganjëher po të godasim por jo personalisht ty por keshtu si institucion KVRL. Eni duke e ditur që aktivizimi rinor është gurthemel për zhvillimin e rinis dhe aktivizimi I tyre ndikon ne cilesin e jetes se të rinjeve dhe statusit te tyre shoqeror ne promovimin e pjesemarrjes se te rinjeve ne procesin e vendim marrjes, si rekomandim qe dua ta jap personlisht ty është që me marr pjesë sa më shumë në takime

publike, kjo ndikon se sa ma aktiv qe jeni sidomos tek degjimet buxhetore, ju me I paraqit kerkesat e juaja qe I keni, e pash qe keni kerkes edhe rritjen financiare ateher qofse keni me marr pjes ne keto takime publike keni me I paraqit kerkesat edhe keni me pas sigurimin e financimit ne propozimet e juaja ne lidhje me rinin apo qdo investim qe ju e shini te nevojshem po ashtu nje sygjerim qe ju si KVRL qe te vini te jeni aktiv dhe ti monitoroni seancat e kuvendit komunal duke e ditur qe kuvendi komunal eshte organi me I lart ligjvenes ne komun eshte mir qe te jeni aktiv ne seanca sepse e rritni edhe dukshmerin e juaj si KVRL edhe kerkesat e juaja jan me prezente per ne faleminderit.

### Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë Teuta, Mon Selmanaj e ka fjalën

### Mon Selmanaj

Faleminderit kryesus përshëndetje zoti Kryetar edhe për ju, zoti Mushkolaj kryetar i këtij organizmi, drejtorët te nderuar dhe ju kolegë.

Në këtë raport të KRVL-s përveç përshkrimit të objektivat strategjike të aktiviteteve dhe arritjet kryesore, nuk na paraqiten të dhëna konkrete për aktivitetet në teren si për shembull, në pikën një aktivitetet mjedisore dhe ndërgjegjësuese, thuhet: organizimi i aktiviteteve në teren për pastrimin e hapësira publike dhe sensibilizimin për ruajtjen e mjedisit unë mendoj që këtu është dashtë, të jeni pak më konkret dhe ti elaboroni, në këtë raport aktivitetet që kanë përfshi këtë pikë.

Dy fushata ndërgjegjësuese për eko-mjedisin dhe edukimin ambiental në shkolla, nuk e keni potencuar në cilat shkolla është zhvillu ky aktivitet tjetër te aktivitetet sportive, keni thënë që bëhen organizimin e aktiviteteve sportive për të rinjt cilat janë këto aktivitete?

Në cilat fusha dhe ku janë zhvilluar? Keni kërkuar ndihmë keni paraqitur vështirësi financiare i keni eleboruar keni rekomanduar mbështetje më të madhe financiare këtu ne u mështesim ty edhe kërkesat e juaja, sepse pa mjete nuk mund të edhe të funksiononi. Prandaj, ky raport është tepër i mangtë në përshkrimin e aktiviteteve shpresoj që në raporte tjera En të jeni pak mv fleksibel edhe konkret. Ju faleminderit.

### Hajdar Sutaj

Faleminderit Mon, En në lidhje me atë që e tha Teuta edhe Moni e keni fjalën

### En Mushkolaj

Teuten dashta me falënderuar kryesisht për përkrahjen që ajo paraqiti për KRVL-n ndërsa për z.Mon dashta me than që aktivitetet për ekomjedisin janë mbajt kryesisht në dy punëtori që kanë qenë përfshirë nga 15 persona, ku e pranishme ka qenë edhe Drejtoresha e Kulturës Rinisë dhe Sportit edhe atëhere, ka qenë edhe kjo pjesëmarëse edhe kjo është kon e publikume.

Pjesa e sportit, ku të rinjtë e kësaj komune çka kanë marrë pjes, ka qenë tek gjitha sportet që kanë mbajt gjimnazet, ku kanë qenë turnirat e futbollit, handballit, volejbollit dhe aktivitete tjera sportive dhe kulturore që janë mbajt si në gjimnaze si në Qendrën Rinore edhe aktivitete tjera që janë mbajt kryesisht kanë qenë prej moshës 16 vjeçare, që i përfshin nxënësit e dy gjimnazeve, që gjenden në komunën e Deçanit deri në moshën 29 vjeçare, ku me status të ri kjo është rritë duke përfshirë numrin e të rinjve që përfshihen në komunën e Deçanit. Faleminderit.

### Hajdar Sutaj

Faleminderit En, a pate dikushj tjetër diqka me thane, po drejtoresha per Kultur Rini dhe Sport e ka kërkuar fjalën fillimisht Drejtoresa fjala per ju pastaj Albesa.

### Drejtoresha

I nderuar kryesus, kryetar asambleistë, drejtorë, gjithë ju të pranishëm.

Ka kohë që nuk jam kanë në asamble për shkak se po s'kom pasë naj pikë po edhe për shkak të angazhimeve që na i kemi pasë në Qendrën Rinore më pengoi pak ajo çka tha Vatani, po edhe ajo çka e është ka flitet kohën e fundit për Qendrën Rinore, po du me jep një sqarim shumë saktë edhe qartë për krejt ata që shumica nuk janë konë ende në Qendrën Rinore. Shumica nuk e kanë as idejen më të vogël as ku është e as çka bohet aty

nëse deri sot nëse nëse... Më falni! Më falni se jam ka foli, për këtë jom dalë dhe me jap sqarime. Për çka ta jom dalë dhe me jap sqarime. Jo ok. Nëse nuk janë postu gjitha aktivitetet që janë bo deri sot në Qendrën Rinore nuk ka ditë që aty nuk mahen aktivitetet. Nuk ka ditë që aty nuk frekuentohet prej të rinjve kom fillu me postu kohen e fundit për shkak që tyne fjalëve. Nuk e kom besu që ka me ardhë dita, që edhe për qatë ven me pas qesi fjalë kam menu që ko menu që njerzit e Deçanit kan me kon krenarë për qatë vend që është bërë kam menu që nuk kom me fol me njerzt e mi sikur me fol me dikon që është, spo di ku me marr ni shembull, nashta i Kamenicës që se ka ide as qka është duke u bërë duheni me dit që në atë Qendër Rinore ka pas njerëz jo veç prej Kosovës ka pas njerëz prej gjitha viseve shqiptare ka pas njerëz prej ambasadave ka pas njerëz prej krejt shteteve të botës që kanë ardhë natë vend e ju asnjeri nuk keni qenë të interesum as edhe njëherë me ardhë edhe me i pa as edhe njëherë me ardhë edhe me i pa, janë dy-tre persona të opozitës që kanë qenë në Qendër Rinore, që kanë marrë pjesë në ato organizimet që e tha Vatani po më vjen shumë keq po ai kompleks po du me jau jep edhe ni qarim në qatë kompleks, ai është kompleks kulturor i trashëgimisë i rinis i sportit edhe i turizmit.

Po du me ju tregu që në atë kompleks nuk është veç objekti i Qendrës Rinore në atë objekt, në atë kompleks është objekti edhe i Kolonisë së Artistëve, është objekt... .....pishina gjysëm olimpikë, fitnessi, janë edhe shtëpizat për akomodim, të cilat janë shfrytëzu nga të gjithë turistët që kanë ardhë në Deçan, që janë për mbi 40.000 turista nëse nuk e dini të gjithë kanë fjetë... papages gjitha shërbimet në qendrën rinore janë pa pagesë, se janë të menaxhuara prej komunës me salla me te gjitha janë pa pagesë kushdo që ka ardhë në atë vend ka mbajt trajnime, seminare kanë mbajt konferenca për shtyp, kanë mbajt promovime, ekspozita, domethënë nuk ka pas as një llojë aktiviteti që nuk është mbajt në Qendrën Rinore ka qen edhe festivali ndërkombëtar dhjetë shtete të botës janë kan në Qendrën Rinore a ka qenë dikush prej juve në atë festival jo.. mu më vjen shumë mirë edhe jam njeri ma i lumtur në botë që jom në qatë vend, që e menaxhoj qatë vend edhe jom njeri ma i lumtur në botë që, përballë, përballë manastirit, na jemi... menaxhojmë aty na organizojmë, se aj është bërë për me organizu festa nuk është bo me organizu ceremoni martore. Jam shumë e lumtur që në atë kompleks edhe zhvillohen aktivitetet, po edhe festa që i kemi çfarëdolloj qofte, kushdo që ka festa edhe tash po i ftoj, si juve si edhe krej qytetarë të Deçanit jo vetem se kam per tu ju ndihmuar per ti organizuar por ka me u be pjesë e qaty ne festat e tyne. Kom me festu bashkë me ta duheni me u ndje krenar, që është aj vend që e ka bërë, që ky kryetar është merita e tij e mas ti vim dhe na. Është mirë me ardh edhe ju ftoj krejtve nuk është mirë me kesh është mirë me ardh edhe me i pa edhe me nejt gjith ditën edhe me pa ni herë e mirë, jo veç ju, por edhe tjerë që janë ka folin është mirë edhe ju ftoj kështu publikisht, jo veç juve, po krej qytetarëve të Deçanit e të krejt të Kosovës le të vinë e ta shohin qysh është Qendra Rinore, kush e menaxhon ata edhe çka organizohet e çka mbahet aty e hajde kqyrni edhe qatë far keqpërdorimin që ju po e quani edhe ajo festë që është mbajt, që e kini pa ju në rrjete.

### Hajdar Sutaj

Drejtoreshë, drejtoreshë...

### Drejtoresha

Me falni se jam duke folur nuk e kam nderpres askend deri me sot mos me nderpreni Ajo fest që e kini pa ju ajo fest nuk është në objektin e Qendrës Rinore ajo fest është në objektin e Kolonisë së Artistëve është në hapësirën ku është e... restorant deri nesër, ai restorant ka me u marrë, me u menaxhu prej dikujt e qaty kan me vazhdu me organizu festa tjera kështu që unë veç ju ftoj me ardh edhe me pa vet, jo me fol permendësh pa qen aty kaq.

### Hajdar Sutaj

Drejtoresh te falenderoj shumë nëse keni mundësi vetëm një minutë, ju përgëzoj per punën që e bëni atje, është koha që na duhet me dal në homazhe edhe e marrë pauz, drejtoresh faleminderit shumë për fjalën dhe për angazhimin, si të përfundojn homazhet 11:15 jemi këtu

### Hajdar Sutaj

Ju lutem të vazhdojmë me seancën, nëse keni mundësi ju tjerët mu ul po vetem rehatohuni njeher, e kam filluar seancën, edhe ju kisha lutur për vemendje.

Drejtoresh po ndalemi edhe po vazhdojmë aty ku edhe e pauzum fillimisht nderimet me te perjetshme, lavdi

dhe nderë për të gjithë të rënë për liri dhe pavarsi për dëshmoret e Deçanit dhe gjithë dëshmoret dhe martirët e komunave të Deçanit dhe të Kombit gjithandej, mundesh me vazhdu, a e ke përfunduar, siq edhe e dini në rendin e ditës është raporti i keshillit veprimi rinor lokal, kishim një përgjigje ose një interpretim të drejtoreshes në lidhje me atë që e ngriti Vatani dhe sa i përket kesaj që e diskutoj drejtoresha vetëm Vatani mundet me u kundërpërgjigj repliken ndërsa të tjerët vazhdojmë me rendin e punës kshillin e veprimit rinor lokal, për temë të tjera e kisha lutur edhe drejtoreshën edhe Vataniin ti përbahehi pikës së rendit të ditës nëse keni diqka e diskutojmë tek të ndryshmet, Vatan Istrefaj e ka fjalën ju ka përmendur emir e kisha lut regjin me ndez mikrofonin të Vatani, flaminderit Vatan fjala për ju.

### Vatan Istrefaj

Faleminderit shumë për fjalën kryesisht së pari, patjetër që do të ndërlihem me drejtoreshën, drejtoresha ndoshta pak të kuptoj por nuk munda me qenë nivelit njëjtë me me përdor atë gjuhë që ti përdorëm me heret. Kjo pikë e rendit të ditës nuk është raport për Qendrën Rinore është raport për KRVL-n të cilin erdhi Eni dhe e mbrojti në mënyrën më të mirë të mundshme po që ti me atë fjalimin tend ja hupe jeshin edhe kesaj punë pasi që na ofendove në përgjithësi si opozit, unë si Vatan nuk prekem asnjëherë personalisht, asnjëherë në kuvendin në Deçan tash po i bëjmë 4 vite mandate kurr personale me ndokënd nuk e kam pasur e sidomos me tym keshtu që drejtoreshë me ato ofendime kishe skeni qenë në qendrën rinore, kam qenë në qendrën rinore disa here edhe sa here kam ardhur kam parë familjarizëm aty keshtu po të them troq, kemi parë familjarizëm kemi parë duke pirë birra tërë natën duke bërë meze duke degjuar muzikë me qitelia edhe nëse ndonjëra nga keto fjalët nuk është eja si të duash përballemi, unë personalisht nuk mundem të dal të mbroj të keqen për të mirë kete duhet ta dish, është e vërtetë që në qendrën rinore mbahen edhe aktivitete creative për rini kam qenë edhe unë present në një takim shumë në rregull është ajo, por diqka që është realitet nuk mundesh ti me dal në foltore që nuk je ardhur që 1 vjet e gjysmë në seanca ndoshta 2 vite edhe me ardh me marr plusa para kryetarit këtu me ardh me na u kap neve është shumë e palogjikshme, drejtresh që 1 vit e gjysmë ke pas pika... besoj të ka thirrë edhe Yllarta disa here me ardhë në seanca dhe nuk ke ardhur ke pasur edhe pika e nuk ke ardhur po ato janë arsye personale të egzekutivit, pse je ardh pse nuk ke ardhur është punë e juaj por nuk mundesh me thënë që nuk ke pasur pika edhe skam ardhur dhe pastaj me ardh pas 1 viti e gjysmë me përdor atë gjuhë ofenduese ndaj neve se ja hupe kuptimin edhe kryetarit që ka ardhur me mbrojt pikën keshtu që herav të tjera je më konstruktive patriotizëm në nuk mundemi me shit jo e kemi qendrën rinore përball manastirit këto janë pallavra që 50 vjetë ju ka kalu afati vjetëm edhe një second këtë qendër rinore e ka ndertu ky kryetar nuk mundesh me jus jell ashtu, kryetar është Bashkim Ramosaj, se ka ndertu kryetari e ka financuar qeveria keshtu me radhë, keshtu që faleminderit

### Hajdar Sutaj

Faleminderit ju lusë edhe një herë naj që ta diskutojmë pikën të cilin e kemi meqenëse ke në diskutim i Vataniin edhe një diskutim i drejtoreshes, më rregulllore ishte drejtë që t'ia kalojmë fjalën edhe për një minutë replik Vataniin, sa i përket pikës, është lajmruar për me diskutu Albesa Cacaj pastaj Moni pastaj Fatoni

### Albesa Cacaj

Mirë, po besoj që po, mirë vërtet, sa i përket çështjes që ju diskutut nuk mundem pa e diskutu e me kalu të kryesisht që ju lus ta diskutojmë qeshtjen të cilin e kemi në plan të rendit të ditës këtë hap është dashur me marrë fillimisht kur u ndryshua temë nga raportimi për planin e punës të kshillit rinor lokal dhe raportimi për aktivitet në qendrën rinore. Në nuk e kemi thirrë sot drejtoreshen por besoj që e din edhe ajo vet me gjithë rrespektin që kam për të për të na raportuar për qendrën rinore është shumë fakt që ka muaj ndoshta edhe vite që drejtoresha nuk ka marrur mundin të vi dhe të raportoj si drejtoresh për kulturë rini dhe sport në komunën e Deçanit.

Sa i përket planit të veprimit rinor lokal, pra plani i veprimit rinor ka të bëjë me veprimin, pjesëmarrjen, arsimimin, punsimin, shëndetësin, dhe probleme dhe qeshtje me të cilat të rinjtë e Deçanit ballafaqohen qdo ditë, duhet për opinionin public ta theksojmë se këtë plan e ka hartuar drejtoria për kulturë rini dhe sport dhe financuesi i projektit është departamenti i rinis në ministrinë e kultures rinis dhe sporteve një raport punë për një plan veprimi rinor lokal duhet të jetë një dokument i qart i strukturuar dhe i mbështetur në të dhëna reale që tregon se si dhe sa janë zbatuar aktivitetet e planifikuara dhe qfarë ndikimi kanë pasur është një raport që informon mbi objektivat e arritura, ky raport të cilin në sot e kemi përpara ka mungesë të informacioneve për aktivitetet e realizuara, pse mendoj që ka mungesë të informacioneve sepse është dashur për qdo aktivitet të

planifikuar në planin e punës të përshkruhet aktiviteti pra lloji I aktivitetit data e realizimit të ati aktiviteti lokacioni ku është mbajtur si dhe pjesmarrja, kur kemi munges transparence dhe informacioni atëher rrjedhimisht nuk mund te dime as rezultate që është dashur të dihen e të diskutohen sot, unë mundem vetëm me supozu që ndoshta gjithë ato që I tha kryetari Eni është e realizushme por ne I nderuar kryetar që në këtë plane te punës të jenë të përfshira aktivitetet e detajuara në mënyr që edhe ne si këshilltar edhe opinion edhe të rinjët e Deçanit të jenë të informuar dhe të nxjerrin një konkluzion se qfar ndikimi ka pasur ky plan I veprimit I cili është aprovuar në 2023 dhe ka koston e realizimit pra kostoja e projektit eshte 36.000 euro pra do të thotë edhe në 2023 edhe pse nuk ka pasur as një raport as një aktivitet te paraqitur ne raport shpenz.. jan kodet qe jan shpenzu ndersa ne vitin 2024 per projektet qe jan parapa te realizohen shifrat eshte 16.200 euro e pash këtu ne fund qe e ke theksuar qe ke munges te financav edhe per mos te zgjatur I than edhe parafolsit, por raporti ti cilin ti e ke sjell sot eshte jo ne harmoni por eshte plotsisht ne kundersizim me objektivat te cilat jan parapar te arrihen ne kete plan si pershebull teatrot kinemat edukimet festat e diteve shfaqjet teatrale garant bibliotekat, shembull biblioteken thotë duhet te rrijt të I nxisim në lexim sidomos ato te zonave rurale, drejtoria ose kryetari ka vendosur që biblioteken me qu atje ku qasja eshte me e paket faleminderit.

### Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë Albësa, En a dëshiron me u pergjigj tash faleminderit, En Mushkolaj e ka fjalën në foltore.

### En Mushkolaj

Tek pjesa e planit te veprimit qe eshte I formulum ne 2023 KRVL nuk ka marrur pjes ne planifikimin e ketyre aktiviteteve dhe nuk ka qenë ende e themeluar tek ajo pjesë, ajo është bërë para se të themelohet KVRL, atëher ai ka qenë I gatshëm edhe aktivitetet që janë të shënuara në atë plan te aktiviteteve nuk është vetëm KRVL-ja është drejtoria e kultures rinis dhe sportit edhe OJQ –t të tjera, tek aktivitetet e she që KRVL nuk është në të gjitha aktivitetet në shumën që ti e ceke 16.000 euro në vitin 2024 dhe tek pjesa e raportit per kete keni plotësisht të drejt mirëpo aktivitetet janë mbajtur edhe tek pjesa e bibliotekës kemi mbajtur takim së bashku me OSBE-n që ka qenë në qendër rinore me kryesin e dy gjimnazeve per frekuentimin e bibliotekes se komunës së Deçanit ku kanë qenë të pajtimit që ajo bibliotek me dal ne qender rinore per arsue se ka hapësir më të madhe eshte nje hapësirë me e re edhe ata kan kushte ku me I frekuentu ato pengesa e vetme e tyre ka qenë vetëm transporti mirpo edhe per transport edhe me ta kemi biseduar e pranishëm ka qenë edhe drejtoresha edhe kemi rënë dakord në të gjitha pikat.

### Hajdar Sutaj

Faleminderit En, Mon Selmanaj e ka fjalën.

### Mon Selmanaj

Faleminderit kryesus të nderuar koleg, inkuadrimi i drejtoreshë në këtë raport me qëllime tendencioze ato tendenca të saj që opozita... dhe ftoi opozitën mos e dhjetë herë që të gravitoi, të frekuentoit qendrën rinore dhe ato objekte atje mendoj se nuk i shërben një mirëkuptimi ne si Asamble, duke ditur që ne jemi pjesë...e asaj qendre pjesë e këtij Kuvendi, pjesë e kësaj komune, pjesë e kësaj Drejtorie për Rininë, Kulturën edhe Sport.

Unë një pyetje kam për drejtoreshen, që sa herë i ke drejtu opozitës ftese zyrtare për evenimente që mahen atje zyrtare, sepse ne nuk mundemi me ardh pa thirr ne mund të vijmë, si e pocentove edhe ti me organizime të tjera edhe kemi qenë, ne perkundrazi vijmë me familjarë tan që vinë prej shteteve të tjera dhe vijmë aty, për qe nuk te vijm ne zyre ty. Ne i frekuentojmë gjitha ato hapësira edhe mburremi ne për ato hapësira, për ato objekte, për ato shërbime që ofrohen aty un nuk po të hij në detaje tjera, ma të hollësishtë se nuk jam informuar sa duhet mirpo na ftosh ne si Kuvend që ti vijmë edhe ti vizitojmë edhe të informohemi rreth atyre, atyre qendrave, atyre objekteve mendoj se nuk të ka hije as ty, as Kuvendit, as gjithëve, duke pas parasysh se ne bile, kjo partia në shtet, kjo bile që ka investuar atje kohet e fundit atje me i thonë nuk po vini kur vjen ministri e vjen atje. E dimë dyqysh nuk e ka atë logjikë, nuk e ka kuptimin mirëpo unë shumë të falenderoj që ty, që na bone ftesë për vizitë amo dhe ne të ftojme ty që me ardh kur te mundesh bile jo çdo muaj, çdo te dytin

muaj me ardh ne mbledhje te Asambles, se kemi edhe pyetje edhe për ju, edhe për sportin edhe për kulturën e për gjitha këto që ju i menaxhoni. Faleminderit!

#### **Hajdar Sutaj**

Faleminderit Mon, ne lidhje me pyetjen e kisha lutur drejtoreshen te mban shenim e te pergjigjet te te ndryshmet se dalim jasht teme, Faton Selmanaj e ka fjalen.

#### **Faton Selmanaj**

Faleminderit Kryesues, përshëndetje për të gjithë, Enin e përgëzoj për punën që e ka bo prej kohës që kam marë mandatin deri më tash edhe e inkurajoj që me bashkëpunu sa ma shumë edhe me neve si Këshilltar komunal pa dallime.

Sa i përket temës te cilen e hapi pa pik nevojë drejtoresha ashtu, i thomë me bindje te plot që kom qenë shumë ma shumë se ti, e që plot do prej juve në kohën sa s'ka pas as një ndërtim aty edhe gjatë kohës sa u ndërtua e deri sa u pre shiriti u mundove të gjitha meritat me ja hudh kryetarit në rregulloj është e ke kryetar tash je varse e tij, mirpo e ka jap një kontribut të vogël në këtë rastë edhe opozita për idet të cilat ka mujt mi dhan gjat implementimit të këtyre projekteve por edhe ne si grup ne veqanti per përkrahje e atyre projekteve kështu që nuk ta kemi për obligim ndonjë ofendim e sa I përket organizimit të asaj qendre rinore dhe menaxhimit unë jam shumë I bindur që këta të rinjë dhe të reja me këtë menaxhim që po ndodh kanë me u dëshpëru shumë shpejtë me faktin që është shumë e vërtet ajo që deklaroj kolegu Vatan unë kam pare me syt e mi në postime në profilet e Facebook-it se aty konsumohet alkohol jashtzakonisht shumë nëpër ndeja, muzika me qitelija e veprime të tjera që nuk kish dashur me ndodh në një qender rinore.

#### **Hajdar Sutaj**

Faleminderit shumë në lidhje me raportin a ka dikush tjetër diçka? Yllarta pastaj Miftari, Yllarta Thaqi e mikrofonin e cilit, në rregull faleminderit.

#### **Yllarta Thaqi**

Faleminderit shumë përshëndetje për të gjithë, fillimisht e përgëzoj Enin për punën më vjen mirë që sot po të njohim En se deri më sot nuk të kemi njoft të paktën unë megjithatë me gjithë këto të mirat që I ke thënë deri sot të inkurajoj që herav të tjera kur e bënë prezantimin ato fjalt e mira që I ke thënë në foltore me I qitë në letër e me na mbet ne si document, se aj document na shërben neve për të ardhmën për me u arsyeu se të gjitha ato aktivitete ke mundur me I pasqyru me një fotografi, e nëse e ke pasur mbështetjen e drejtoris rinis kultures dhe sportit janë diku (...) puntor kan mundur me të ndihmu po ashtu edhe ne jemi të gatshëm për të ndihmuar, sa I përket financave tash është planifikimi buxhetor jemi të gatshëm për të ndihmuar dhe me të mbeshtet dhe me I dërgu projektet tua finale deri ne fund rinia e Deçanit meriton më shumë kaq deshta faleminderit shumë.

#### **Hajdar Sutaj**

Faleminderit Yllarta, mundesh me mbajt edhe shënim nëse dëshiron, Miftar Ahmexhekaj e ka fjalën.

#### **Miftar Ahmetxhekaj**

Faleminderit shumë kryesues edhe pse një pjese të mendimit veç e shprëfaqi Yllarta me vend, kështu I nderuar e para ju në hyrje të fjalimit tuaj e potencuat që ju e keni një staf, e para mirkuptojeni asnjë sulm ndaj teje larg asaj, te pergezoi (...) që e ke megjithatë raporti si I till ka munges I mungon diçka edhe I mungon dhe I mungon diçka thelbësore dhe krejt ajo qka është tek plani I veprimit, ndëgjom sado që mundohesh, momentin që e ke pranuar mandatin duhet të kesh detyrim ndaj këti dokumenti dhe besoj që është dashur ta konsultosh dhe e dyta me qenëse u fol që ke një sekretari këtë është dashur me bë edhe drejtoresha ose drejtoria për kultur, në momentin që e ke një normë që është statusi I juaj është dashur në fillim të raportit ti referohesh të kesh njëfar referenc ligjore do të thotë mbeshtetur ne kete edhe e dyta pershkrimi e detyrav ta bësh më specifike u tha por për raste të tjera tv jesh më konkret, shumë pajtohem dhe dua të mirëkuptoj se të gjitha keto zhvillime ose detyra I ke perfunduar por unë nuk I lexova këto e tha edhe kolegia paraprake ne nuk I pamë

këto dua të besoj por jo të shkruara që të jetë dhe që të arkivohet në të ardhmen ti duhet ta kesh dokumentin e shkruar edhe ti je më ballë hapur për detyrat që I ke perfunduar kaq faleminderit.

### Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë Miftar, En a ke diqka me shtu?

Atëherë kështu po drejtohem kryetar En ty edhe njëherë në emër timin në emër të gjith kolegëve me të falenderu për prezencen për raportin për punën, sygjerimet pastaj jan të mirëseardhura, e tha edhe Miftari nuk ka asgjë tendencioze qdo gjë është në funksion të asaj që me qen më mirë jemi shumë të lumtur me pas rinin e Deçanit shumë aktiv ju inkurajojm me qenë sa më aktiv jemi të gatshëm me ju përkrah si kuvend në kërkesat e juaja jemi të gatshëm me ju mbështet me bashkpunu, konsideronani partner, miqë, pashkëpunor qkado në mënyrën më të mirë të mundshme dhe të urojm punë të mbar ty edhe KVRL-s me shpresen që ende më aktiv keni me qenë më të organizuar keni me qenë dhe ju prift e mbara, me kaq me qenëse është raport e mbylli këtë pike dhe kalojm tek pika e 3-të që është shqyrtimi I raportit të auditorit të jashtëm N.P.L. Higjiena me qenëse kolegët e komisionit të aksionerëve sot nuk janë present e kisha lute kryetarin e bordit të ndërmarrjes zotrin Milazim Mushkolaj që ta bëj fjalën hyrëse mundësisht e shfrytëzoni foltoren zotri Milazim

### Milazim Mushkolaj

I nderuar Kryesues i Kuvendit të nderuar Asambleistë dhe Asambleiste të Kuvendi të Deçanit.

Rregullorja e kompanive publike, ish dasht komisioni I aksionarëve ta bëjë këtë prezantim të këtij raporti por fatkeqësisht këtu nuk po e shoh asnjërin prej tyre pom doket ju e keni ndrru komisionin a mua personalisht nuk më ka njoftuar askush, unë e kam bërë një raport e kam prezantuar te ata para një jave dhe nuk po I shoh këtu kjo eshte pak edhe per keqardhje edhe per ju qe nuk I keni këtu por megjithatë nëse më lejohet unë mundem ta bëjë nje raport të shkurtër tv këtij raporti të auditorit të jashtëm të qertifikum I cili është cilsuar në terma të auditimit është raport I mir është raport (...) që do të thot se financat në kompanin publike Higjiena I nënshtrohen standardeve më të mira të mundshme dhe nuk ka pasur (...) e vetmja gjë që është theksuar në këtë raport janë dy theksime që me standarde të reja ndërkombëtare të ndërmarrjeve publike vlerësimi I asetëve në kompani publike tash e tutje do të bëhet nga vlerësus të jashtem të cilët do te perzgjedhen me konkurs do te thot me prokurorim jo me zgzjedh ti me thene eja vlersomi asetet po me qenë I qertifikuar edhe me kon tenderum per me bë një punë të till, kompania publike Higjiena jo vetëm Higjiena por asnjë kompani në Kosovë as lokale as regionale nuk e ka bërë një vlerësim të till edhe kjo na eshte theksuar si theksim edhe ne theksim tjetër ka qen mos kryerja e disa obligimeve sipas ligjit per ndermarrje publike 03-87 që ndërmarrja publike duhet të kompletohet me drejtus me digaster siq eshte sekretari I korporatës edhe auditori I mbrendshem mirpo këto janë process që nuk janë përfunduar ende, per raportet tjera e keni ne raport I keni te pasqyruara edhe raporti financiar edhe auditori I vlerësimit kështu qe nuk kisha pasur me shtu diqka tjetër mua si drejtus I bordit mundem me ju falenderu per punen qe e beni se jeni aksionari kryesor I vetmi aksionar edhe nese e keni vërejt aty kur e kam lexuar raportin pasqyrat financiare do te thot kompania me 31 dhjetor ka perfunduar me fitim diku afërsisht 40% më shumë se fitimi I vitit 2023 edhe te shpenzimet nëse e keni vërejt janë zvogëluar shpenzimet e furnizimit me karburante edhe ka pasur shumë aspekte që janë per tu vlerësuar kaq kisha faleminderit.

### Hajdar Sutaj

Zotëri Milazim, të falënderojmë faleminderit shumë mundesh me zënë ulësen nëse ki mundësi me majt shënim edhe mundesh me u përgjigj pastaj në tema të cilat kolegë mundën për me i ngrit gjithsesi, te falënderojmë për pjesëmarrjen, për prezencën edhe për paraqitjen që pate, prezentimin që pate ashtu siq e kemi edhe zakon fillimisht në emër të subjekteve politike nga Aak-ja në rregull nëse keni dikush diqka me thanë, atëherë Florim Mataj e ka fjalën.

### Florim Mataj

Përsëndetje, kryesues përsëndetje kolegë unë dashta me qenë se nuk di se sa eshte ligjerisht e drejt te pergjigjet kryetari I bordit me qenëse nuk jan aksionert nuk e di un nuk pata shum ndoshta edhe kisha propozuar te shtyhet per seancen tjetër kur te jen edhe aksioneret kur te jen present edhe anetaret te tjer te komisionit sepse nuk e di edhe sa eshte I gatshem drejtori me na u pergjigj

**Hajdar Sutaj**

Faleminderit, ne emër të Ldk-së Miftar Ahmetxhekaj.

Miftar Ahmetxhekaj

Faleminderit shumë kryesus, përgjime për kryetarin e bordit unë realisht e ndaj perafersisht të njëjtin mendim të shkoj pak edhe me tutje me parafolsin me qenëse kompania publike komunale është e themeluar nga aksionari në këtë rast aksionar është komuna e Deçanit dhe ai aksionar nëse e përkthejmë në gjuhën popullore janë taksa të qytetarëve dhe ky aksionar e ka një komision dhe ai komision padyshim është dashtë me qenë present sot për shkak se unë nuk mendoj që i nderuari është .. ka shumë mandate me u përgjigj për pyetjet që unë mundem me i shkoqit tani për tani e para adutimin e ka bërë një auditor ligjor për të cilin unë kërkoj cila ka qenë procedura perzeshja e këtij auditori, ky auditor a është dashur të ketë një licens brenda këtij raporti, raportin qysh në fillim fillon me fjalën “në mendojmë” ndërsa të kualifikimi thotë është i pakualifikuar mendimi është përshtypje raporti duhet të jetë pasqym i pasqyrave financiare të sakta ka të gjetura, ska të gjetura kur jemi në këto dilema unë absolutisht me vjen keq me thane por për mua për vlersimin tim është raport jo kredibil dhe është pak po më vjen keq por kompetentet të cilët është dashur të jenë present sot dhe paguhen për këtë punë, nuk janë kaq.

**Hajdar Sutaj**

Falemindert Miftar Kolegu jonë që është kryesuesi i komisionit të aksionerëve Shkodran Mustafaj me lejoni që edhe kështu live të i uroj (...) sot e ka ceremoninë e ka shënuar një hapë të rëndësishëm në jetën e tij i urojmë shëndet fat e mbarësi, Lëndita ka pasur arsye familjare ndërsa Manjolla na u bashkua këtu dhe mendoj që edhe Manjolla edhe Milazimi...

Vitin e kalur unë kam pasur disa vërejte prej disa prej juve kolegë që nuk e kam lejuar me bisedu ose me u shpreh përfaqesuesit e bordit ndërsa tash e kam të kundërtën dmth bordi është këtu por është dashur komisioni i aksionerëve kisha menduar me qenëse e kemi edhe Manjollën edhe Milazimin me vazhdu, nga Vetvendosja kush dëshiron me diskutu, Faton Selmanaj e ka fjalën.

**Faton Selmanaj**

Po faleminderit kryesus, për vazhdim ose mos vazhdim deklarohen grupet kështu që me sy ja bëre të pash po, ata u deklaruan që janë për me shty edhe kolegët nga Ldk-ja u deklaruan për me shty edhe në jemi duke e pasur para sysh që nuk janë as anëtarët as aksionerët as kryetari nuk është present që ish dashtë me qenë edhe kryetari këtu se është personi kyq thujse që i bart aksionet mendojmë që duhet mu shty për një seanc tjetër

**Hajdar Sutaj**

Ëh, Faton, unë...

**Faton Selmanaj**

Ashtu e kështu, është e paraparë në qershor me u mbajtë

**Hajdar Sutaj**

Po në rregull

**Faton Selmanaj**

Është me plane të punës

### Hajdar Sutaj

Unë e pash që po diskutojnë këta përderisa ti fole edhe e pata një kërkesë sinjalizuese për mirëkuptim për me të degju përndryshe nuk më bën përshtypje personalisht nëse e diskutojmë tash ose e diskutojmë mbledhjen e ardhëshme është i njëjti raport nëse ju e vlerësoni me shty e shtymë.

Më falni Mon Selmanaj

### Mon Selmanaj

Faleminderit kryesisht edhe unë i mbështes këta parafolsit ose përfaqësuesit e subjekteve politike që kjo pikë e rendit të ditës të kalojë në seancën e radhës për arsye që mungojnë komisioni i aksionarëve

### Hajdar Sutaj

Më falni me ju bo një pyetje po zonjusha këtu Manjolla keni ju ndonjë dilemë në lidhje me prezantimin e saj Florim urdhëro.

### Florim Mataj

Nëse më lejohet me kalu ndoshta në temën edhe pak që po e bëjnë si në humor qëndrimi i grupit tonë kërkoj për me shty kështu që edhe pak grupet ....këtu e pata nuk pata diçka ma shumë grupi jon ishte për me shty dhe me vazhdu me grupet tjera

### Hajdar Sutaj

Unë edhe e bëra atë që është duhet unë nuk e përfundova me propozimin e juaj pa i marr edhe mendimet e tjerëve të gjitha subjekteve dhe tash po e qes në votim a jeni për me shty

A ka kundër?

A ka abstenim?

Konstatoj që Kuvendi Komunal, tash a po dëgjoni, fol unë fol ju qëfar po ndodh këtu, atëherë kështu konstatoj që Kuvendi Komunal ka marrur vendim për me shty diskutimin e raportit të auditorit të jashtëm për mbledhjen e muajit Qershor me rekomandimin që në mbledhjen e ardhëshme të jenë present Komisioni i Aksionarëve faleminderit shumë vazhdojmë me pikën 4 që është shqyrtimi dhe miratimi i propozimit vendim për pagesën e kryetarëve të keshillave të fshatrave fillimisht në lidhje me këtë vendim edhe propozim vendim e kisha lutur drejtoreshën për buxhet dhe financë Dafina Cacaj që ta marrë fjalën, Milazim faleminderit shumë.

### Dafina Cacaj

Faleminderit kryesisht të nderuar anëtar të asamblesë të nderuar drejtor unë e kam sjell një kërkesë për pagesën e keshillave të fshatrave të cilat parashihet me udhëzimin administrativ 02\ për 2019 që të bëhet pagesa e tyre për 6 takime brenda vitit mirpo nuk specifikohet kategoria nga cila duhet të paguhet, unë jam nisur shumë nga ajo që shumë komuna kanë marrur verëjtje viteve të kaluara prej kategorive të cilave e kanë bërë këtë pagesë se me duket nuk i takon kategorisë së subvencioneve shumica e komunave veç e kanë bërë nga ajo kategori unë e kam menduar dhe e kam propozuar që me marr vendimin me bërë nga kategoria mallra dhe shërbime, kjo pagesë behet në përputhje me dy komitetet që janë obligative që janë komiteti për politikë financiare dhe komiteti të komuniteteve nuk po e di duhet me provu ndoshta marrim edhe në verëjtje nga kategoria mallra dhe shërbime mirpo ata janë duke punuar në terren dhe dalin edhe mbajnë takime me qytetaret e tyre dhe po kërkojnë pagesën me ju bërë, me provu nga kjo kategori nëse nuk marrim verëjtje atëherë vazhdojmë nëse jo atëherë duhet me gjetë një formë tjetër unë kam komunikuar edhe me komuna të tjera edhe me ministrin mirpo që nuk e kanë specifikuar në cilën kategori duhet me pagu ose që është e përshtatshme, kërkoj nga ju që të votohet dhe të mundem edhe unë ta kryej pagesën ndaj tyre se me kanë shkuar bukur do muaj që nuk kam mundur me bërë pagesën faleminderit.

**Hajdar Sutaj**

Drejtoresh të falënderojmë shumë, na kemi shprehur mirkuptimin dhe përkrahjen tonë edhe ne komitetin për politikë dhe financa e kemi edhe të rekomandimet, në emër të grupit të Aleancës Arian Dobraj, Florim Mataj e ka fjalën

**Florim Mataj**

.....

**Hajdar Sutaj**

A kemi ndonjë problem? Miftar në rregull vazhdo.

**Miftar Ahmetxhekaj**

Mos e qaj hallin, kryesisht faleminderit shumë, sa I takon temës jamë ndoshta nuk po themë prej te vetmit por e kam ngritur si çështje ka disa seanca që unë e kam vlerësuar se disa këshillat ju kemi hyrë në hak ose ju ju kemi hyrë në hak dhe dua ti potencioj janë disa vendbanime që realisht kanë mbajtur takime ne po flasim pjesë dermuese e këshillave të fshatit janë zgjedhur diku në muajin tetor të vitit 2023 që I bie komplet viti 2024 nuk është dhënë ndonjë zgjidhje, dhe janë shembull du me marrë Isniqi është prej te vetmev që ka mbajtur takime të rregullta kryesia ose këshilli I fshatit nuk dua ta largoj as Deçanin ose Cerrabregun ose Isniqin që I kam parë në rrjetet sociale unë e kam një dilemë në raport me ju pak me qenëse këshillat janë zgjedhur në muajin tetor të vitit 2023 ka qenë kohë e mjaftueshme që ju ta parashini planifikimin të buxhetit dhe për mendimin tim është dashur të jetë nga kategoria e subvencioneve nuk ka asnjë dilemë që këta duhet të paguhet, le që I mbështesim por unë e vlerësoj që ne jemi vonuar në këtë hapë por tash te opinioni ligjor a kemi me marrë nga mallrat unë dyshoj nëse ju vlerësoni absolut që e kemi mbështetur te pa te pa te pa kushteve gjithsesi por jeni vonuar pak edhe këto nuk po du qysh me than me penalizim po shpesh herë verjetet që I bëj në planifikim prap dalin e kemi një problem në planifikim dhe është dashur për shkak se udhezimi e ka than që duhet të paguhet modalitetin është dashur ta ta zgjidhni ose të konsultoheni me ministrin e financa nuk ka kurgjo të keqe faleminderit shumë.

**Hajdar Sutaj**

Patjetër drejtoresha e ka të drejtën e vetë gjithmonë, drejtoresha për Buxhet e Financa Dafina Cacaj e ka fjalën.

**Dafina Cacaj**

S'ka problem nuk ka të bëjë me planifikimin na jemi kan të gatshëm me pagu edhe vjet, mirëpo vjet as ata nuk janë kan në ndijeni për procedurat që duhet me i kry për me mujt me i pru disa letra të unë që me mujt me i kry pagesat.

Në fillim vit i kan pru do që muna me pagu retro, mirëpo e kanë veç një takim ose dy bashkangjitne me ato dokumenta që unë i kom marrë dhe ko me kry edhe atë edhe për këte pjesën e këtij viti, nuk i kan pru krejt...këshillat e fshatra, procesverbalet edhe listat e nënshkrimeve as letrat e tyre se kujt kan me I dal mjetet kemi pasur telashe se shumica janë veteranë, por shumë telashe me bo zgjidhjen për me u bo pagesën na e kemi majt ni takime dhe tash po mendoj që e kemi zgjidh, mirpo nuk ka të bëjë me vullnetin ose me mundësin buxhetore.

Kemi pas telashe teknike që u kanë pak e vështirë deri sa jemi sistemu me ta, po unë du me e provu kategoria e subvencioneve nuk i takon se unë mendoj se subvencionet janë për me ndihmu dikujt, na nuk jemi duke ju ndihmuar atyre ata janë duke kryer shërbim edhe na kem me pagu për shërbimin që e kryen për këtë arsye unë kam menduar që kategoria ma e përshtatshme është mallra shërbime, mirpo nuk është naj problem buxhetor është problem vetëm me gjet kategori ku përshtatet ma shumë për këtë arsye edhe jam drejtuar te ju.

## Hajdar Sutaj

A bën me përfundim kolegë të tjerë pastaj po kthehem te ti, nga Vetvendosja Faton Selmanaj.

## Faton Selmanaj

Faleminderit kryesus, po filloj nga fundi drejtoresh deklarave që janë shumica veteran unë bash I numërova nja 11 që po I njohë nuk janë veteran fillimisht e kam një pyetje për fshatin Strells I Epërm I cili nuk ka zgjedhur këshill të fshatit a ka pasur një kërkesë për zgjidhje nëse ka dikush ndonjë përgjigje se nuk qenka drejtori Jashar këtu, sa I përket pagesave të tyre mbi të gjitha na e kemi edhe obligim ligjorë me kry këtë punë, në fakt ju dhe tash disa prej tyre mendoj që edhe duhet pak me I mësu për procedurat e me ju tregu pak më në detaje se qfar me vepru për me kry obligim që është ndaj tyre faleminderit.

## Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë zotëri Faton, realisht kish mundur me na u përgjigjur dikush nga anëtarë e komisionit këtu është Fikria, Miftari por ta dëgjojm njëher zotri Mon Selmanaj

## Mon Selmanaj

Faleminderit kryesus unë në parim mbështeti këtë kërkesë drejtoreshë, mirëpo ndoshta është dashur që në këtë kërkesë të specifikohet se sa seanca duhet të paguhet këta kryetarë të këshillave fshatra mendoj që është dashur të na vije e specifikime edhe sa seanca jemi obligativën me i pague kryetarit të këshillit të fshatrave se ju keni potencu këtu sa komitetet paguhet sa komitetet obligative mirëpo komitetet obligative është KPF-ja, për shembull, e cila për çdo muj ka seanca kështu që si kërkesë ndoshta ka qenë shumë ma drejtë me qenë edhe e përcaktume seancat sa seanca në vitë paguhet ju faleminderit.

## Hajdar Sutaj

Zotëri Mon, po më duket që pak ka pas mundësi edhe me të ik sepse të rekomandimet e KPF-s e ki edhe ju keni qenë edhe atë ditë prezent në takim keni qenë present po ka qenë edhe në mbledhjet e KPF-ës prezent edhe janë të rekomandimet që tregojn edhe sa takime paguhet edhe sa është shuma e vërtetë, zotëri Mon po ti.. na kem pasur knaqësi në mbledhjet e KPF-ës me të pasur prezent edhe kur i kem nxjerr rekomandimet e KPF-s, ke qenë aty gjithsesi je shumë i mrekullueshëm edhe na të rrespektojm edhe të falënderojmë shumë, Dafina e ka fjalën nëse done, apo donë me i dëgju edhe këta tjerët, Miftari kishte diqka shtesë pastaj Albesa gjithsesi edhe pastaj te drejtoresha.

## Miftar Ahmetxhekaj

Tash kjo kolegja Yllarta e ka durimin 1 minut nuk e kam shumë, drejtoresh fjala ime ke në kontest pse kjo kërkesë nuk ka ardhur në fillim të vitit 2024 varësisht nga procesverbalet bëhen pagesat vendimin ta ndani për shkak se këshillat e fshatrave nuk kanë marrur pagesë kanë kryer detyrat po supozoj se ju e potencuat që disa I kanë sjell procesverbalet ky detyrim pse nuk është kryer në vitin 2024 atëher varësisht nga detyrat që kryhen nga mbledhja procesverbale bëni pagesen sa I përket fshatit Strells kryesus ne I kemi pasur 2 tendenca për shkak te lokalitetit nuk kemi mundur me mbari domethan kemi provu dhe e kemi mbyllur me raport domethan Jashari ka qenë kryesus por nuk kemi mundur me mbari konsensus për zgjedhjet e këshillit të fshatit.

## Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë, Albesa.

## Albesa Cacaj

A të vazhdoj... planifiku buxhetin e vitit kompensimi i anëtarëve të këshillave lokal edhe u shtrua... pyetja me të drejtë, sepse këto, kjo veprimtari që ushtron kryetarët e këshillave lokal e ka bazën ligjore tek udhëzimi Administrativ, ku specifikohet konkretisht se për punën e tyre, kryetarët e këshillave lokal kompenzohen nga buxheti i komunës përkatës, që domethënë rrjedhimisht duhet të jenë të planifikuara dhe këtu po del pastaj

problemi se nga cila kategori duhet ti marrim në qofë se i marrim nga mallra dhe shërbime, ato janë planifikun qershor vitit 2024 për vitin pasardhë dhe besoj që lihet diçka keq aty për t'i marë dhe kompenzu.

Sa për qartësim të opinionit, kompensimin për kryetarët e këshillave lokal bëhet në shumen ekuivalente pra, siç e marrim një pagën ose kompensimin te Komitetit për Komuniteti ose Komitetit për Politikë, Politikë dhe Financa edhe në qoftëse i mbajnë 12 mbledhje ata kanë drejtë të paguhen veç për gjashtë brenda vitit faleminderit....kisha dasht me ditë sa është shuma totale për kompensim pra nga themelimi tyre që është prej 05.07.2023 sa i kushton total buxhetit të komunës ky kompensim i kryetarëve të këshillave lokal faleminderit.

### Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë, Albesa e dëgjojmë edhe Yllartën edhe pastaj përzgjidjet drejtoresha, Yllarta Thaqi e ka fjalën.

### Yllarta Thaqi

Faleminderit e konsideroj se për këtë temë kemi folur me dhjetra here këshillat e fshatrave kanë ekzistuar edhe ma herët ky legjislacion, ata më herët nuk janë pagu pse nuk është bërë planifikimi? Për arsye se nuk janë pagu ma herët këshillat e fshatrave tashmë kur janë zgjedh nëse nuk është bërë planifikimi, mundet me u bo planifikimi edhe prej mallrave dhe shërbimeve dhe me u kry obligimin ndaj tyre nëse i mbajnë 20 takime, ato 6 takim të rregullta kanë me u pagu edhe nuk është kijamet sa jemi duke e bërë, faleminderit se dëgjova edhe ty kolegë spo ta përmendi emrin se po e merr fjalën apert, po këtë temë e kemi konsumu deri në maksimum nuk e di pse duhet për me e diskutu edhe njëherë.

### Hajdar Sutaj

Faleminderit Yllarta, a ka dikush që nuk ka diskutuar për këtë temë.. po me knaqësi edhe mos me të dëgju ty

( )

Faleminderit kryesus për të mos e zgjatur shumë ne së bashku me drejtoreshen per politik financa e kemi diskutuar këtë kërkesë së pari kemi vlerësuar që ta dime pagesën cila duhet të jetë e cila edhe eshte per 6 herë brenda vitit te gjitha I kemi te qarta edhe besoj qe edhe me vones jemi pro kesaj kerkese qe e ke sejll ne seancen komunale menyra se si ti I siguron fondet eshte pjes e juaja kjo është mbi të gjitha faleminderit edhe me këtu besoj e perfundojm këtë pike.

### Hajdar Sutaj

Falemnderit shumë, drejtoresh besoj qe nuk ke diqka te pa kjart edhe shqetsimet edhe diskutimet I kemi miratuar e qes në votim.

Kush është për?

A ka kundër?

A ka abstenim?

Konstatoj që kuvendi komunal ka marrur vendim dhe e ka miratuar propozim vendimin e drejtoreshës për buxhet dhe financa për kompensimi ose pagesat e kryetarëve të kshillave të fshatrav, kolegë I kemi pikët e rendit të ditës dhe e marrjen e vendimit për shpalljen qytetar nderi të dy personaliteteve të cilat janë propozuar njëher njërin propozim e keni nga kryetari I komunës zotri Bashkim Ramosaj për kolonelin amerikan Tod Jakobs me motivacionin per kontributin e jashtëzakonshëm në përforcimin pertneritet ndermjet Kosovë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, vazhdon motivacioni të cilin ju e keni lexuar dhe e kemi propozimin tjetër nga Lidhja e Historianëve nga Dega Ali Hadri në Deçan, ta mbajm pak qetësi, Zotri Marin Mema për kontributin e dhënë në ndriqimin dhe hedhjen në dritë në shumë ngjarje dhe personalitete të historis tonë Kombëtare Shqipëtare me qenë se vendimen mirren veq e veq edhe diskutimet munden me qen veq e veq per të dy, e kisha hapur diskutimin fillimisht grupit të Aleancës për Ardhmërin e Kosovës Arian Dobraj është në lidhje me kërkesën e kryetarit pastaj për kërkesën e dytë

**Arjan Dobraj**

A me diskutu për të dyjat?

**Hajdar Sutaj**

A e diskutojmë ndaras? A po doni të dyjat përnjëherë si po doni, në rregull dyjat përnjëherë.

**Arjan Dobraj**

Mir faleminderit kryesus edhe një herë përshëndetje për të gjithë edhe për ju drejtor, pak a shumë jemi në ngjarje për kontributin që ka dhënë Tod Jakobs nëse nuk gaboj (Jakobos) në komunën e Deçanit nuk e di sa kanë njohuri të gjith kolegët po jemi në ngjarje që ai kohë pas kohe e viziton komunën edhe është munduar me sjell qoft edhe projekte të ndryshme që kanë ndihmuar në jetën sociale dhe kulturore të komunës së Deçanit kështu që jemi për edhe kërkesa jonë që të del në votim jem pro si grup për të dyjt për shkak edhe të Marin Memës so kontibus I madhë në qështjen kombëtare faleminderit.

**Hajdar Sutaj**

Arian faleminderit shumë, nga Ldk-ja Miftar Ahmetxhekaj

**Miftar Ahmetxhekaj**

Kryesus pa e zgjatur shumë në emër të grupit parlamentar ju jepi mbështetjet të dy propozimeve edhe nga kryetari Bashkim Ramosaj dhe nga shoqata e historianëve dega Ali Hadri në Deçan, faleminderit.

**Hajdar Sutaj**

Faleminderit shumë, nga Vetëvendosaj Faton Selmanaj e ka fjalën urdhëro

**Faton Selmanaj**

Faleminderit kryesus edhe në si grup i mbështesim këto dy kërkesa edhe kërkesën e kryetarit Ramosaj, edhe kërkesën e Lidhjes së Historianëve të Kosovës Ali Hadri Dega në Deçan.

**Hajdar Sutaj**

Faleminderit shumë Faton, zotri Mon Selmanaj fjala për ju.

**Mon Selmanaj**

Faleminderit kryesus pasi që me regjistrimin e popullsis kemi rënë shumë mendoj se partia në pushtet është duke e shfrytëzuar me bënë qytetar të Deçanit kështu për qdo muaj nga një ose dy kështu që edhe unë e mbështes këtë edhe pse (...) mirpo si figura këtë të dytin e njoh për afërsisht kam lexuar kam dëgjuar e mbështes për gjeneralin na mbet mangu shefi I grupit të Aak-s që nuk na dha sqarime se qfar ka bërë për Deçanin dhe qfar ka kontribuar ju faleminderit, kishte me qenë mirë zotri Arian me na spjeguar kontributin e tij se në të tjerët jemi pa njohuri.

**Hajdar Sutaj**

Të lutem e keni biografinë e tij realisht biografinë e dyve dhe fushveprimtarin e të dyve I keni pasur të shënuara edhe besoj që keni mbri edhe me I lexu atëher I qes në votim te dytë.

Kush është për? Me I shpall qytetar nderi dy propozimet.

A ka kunder?

A ka abstenim?

Konstatoh që kuvendi komunal I Deçanit në mënyr anonime ka shpall qytetar nderi kolonelin amerikan Tod Jakobs edhe zotri Marin Mema, jemi tek pika e te ndryshmeve a keni diqka, Faton Selmanaj.

**Faton Selmanaj**

Faleminderit kryesisht unë kam një pyetje, në fakt një pyetje dhe një kërkesë e di që nuk është kompetenc e drejtorit në fjalë por ndoshta mundet një kontribut sado të vogël me jap, më ka rastit me taku disa bujq edhe kan pasur shumë ankesa për të mbjellat e këti viti në veqanti në ato të drithërave edhe dyshimet e tyre drejtor Rifat kanë qenë që fara ka qenë e skaduar realisht një kërkesë për me I përcjell atë lloj fare e kam drejtuar edhe në ministrin e bujqësisë por po ta drejtor edhe ty që nëse mundesh tash me bashkëpunu pak me inspektoriatin edhe me shiku në barnatoret bujqësore të cilat egzistojn në komunën tonë atë lloj fare që a është I vërtet pretendimi I bujqëve apo nuk është sepse dëmet ishin kogja të mëdha me të thënë të drejten ishin me mijëra euro që ishin duke shpenzuar për mbjelljen e dytë faleminderit.

**Hajdar Sutaj**

Falemindert shumë, drejtor Rifat Stojka fjala për ju.

**Rifat Stojkaj**

Përsëritet për të gjithë, Faton faleminderit për ngritjen e shqetësimit me të thenë drejtën, nuk kam dëgjuar për këto raste nuk kam marrur ndonjë feedback nga qytetarët ose nga bujqët që janë ankua, por paska bazë me u merrë me këtë temë.

Nuk është përgjegjësi e jona, janë ekspertët, inspeksioni i tregut, inspeksioni i ushqimit dhe veterinarit që mirren me këtë temë po që padyshim që kemi me shku me i vizitu edhe me I shiku keto tema ndonjëse nuk kam marrur ndonjë shqetësim nga askush deri në këtë moment

**Hajdar Sutaj**

Po edhe një pyetje shtesë ka Fatoni.

**Faton Selmanaj**

Drejtor Rifat e thashë fillimisht që nuk është kompetenc e juaja por menojm që mundemi me jap një kontribut në këtë drejtim, më kan treguar edhe emrin e fares se cila është për besë nuk e di as cila kompani është distribut e asaj fare ndoshta mundemi pak me u konsultu edhe me këto farmaceut ose barnatoret bujqësore në komunën tonë edhe me I pytë a është e vërtet që ajo lloj fare ka qen me afat të skaduar

**Hajdar Sutaj**

Po po patjeter drejtori prapë e ka fjalën, drejtor Rifat Stojkaj.

**Rifat Stojkaj**

Faleminderit, pa dyshim që kemi me trajtu si qështje po u nxitu me dhënë një informacion që është I mirë para 11 dite ka përfunduar aplikimi I fermerëve për subvencione, fermer që aplikojn nëpër zyrat e drejtorive të bujqësisë nëpër komuna, komuna e Deçanit për vitin e 5 me rresht shënon ngritje sa I përket rritjes së fermerëve që punojn token më shumë dhe kultivojn sfera të ndyrshme të bujqësisë, në vitin 2019 kan qenë 590 fermer sakt me numer ndër 600 fermer që kan aplikuar për subvencione këtë vitë kemi numër rekord që janë 957 fermer që aplikojn për subvencione kategorit që jan shtuar që është rritur niveli me se shumti është rritur niveli I fermerëve që aplikojn (...) blegtoris pra kemi numer me shumë sa I përket fermerëve që aplikojn për produktet e qumshut është rritur niveli I atyre që aplikojn në perimtarit por edhe në sektorët që I përmende ti në grun dhe në miser padashyrim që kemi me u marr me këtë qështje faleminderit shumë për shqetësimin.

**Hajdar Sutaj**

Faleminderit, Blinera është lajmruar për fjalë

## Blinera Lokaj

Faleminderit kryesues unë e pata një pyetje për kryetarin e komunës edhe pse nuk është i pranishëm megjithatë unë po e parashtrij pyetjen dhe mundet mu përgjigj në seancën e ardhshme, pyetja ka të bëjë në lidhje me postimin e kryetarit, në lidhje me vizitën e Ministrit për Zhvillim Rajonal dhe prezantimin e projektit për ndërtimin e tetë urave në zonën malore, pesë prej të cilave dërgojnë në mbjeshkën Pllaqica e Vokshit. Pyetjet të cilat desha ti parashtrij janë: Cili është statusi aktual i këtij projekti? A është veç propozim apo ka filluar ndonjë procedurë konkrete për zbatim? Sa është vlera totale e projektit dhe si do të bëhet ndarja e financimit në mes të Ministrisë dhe komunës? A është bërë studimi i fizibilitetit dhe i terrenit, si dhe përfund kur pritet të fillojë dhe të përfundojë realizimi i këtij projekti? Përndryshe, është për tu përgëzuar që më në fund këto ura po ndërtohen me beton, pasi që ka qenë edhe kërkesë e imja në kuvend kështu që veç suksese në ndrejtim të implementimit të këtij investimi.

## Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë Bleniera dhe pyetjet tuaja janë edhe në transkript edhe po besoj që ke me i marë edhe përgjigjet mos tash në mbledhjen e radhës, është lajmëruar Miftari, Sylva Vatani, Albesa kjo është renditja.

## Miftar Ahmetxhekaj

Kryesues faleminderit shumë, ju bartni funksion edhe njëfar rregullatori I mbarvatjes së punimeve në seancat e kuvendit unë ka kohë që kam dashur me ngrit si shqetësim dhe përfundimisht pe ngriti sot dua te rezervohem nga fjalori por njëfar kultuore jo adekuate nëse ndërhysh kusdo qoftë kolegë duke përshpërit gjatë fjalimeve që ne I mbajm.

Ju në momentin që përcaktoni rendin e ditës po vlerësoj pikat të cilat I përcaktoni besoj që janë pika jo të konsumshme momentin që vin pika te rendit të ditës unë mbi bazën e mandatit që e kam nga vota e qytetarëve është në të drejten time të diskutoj është jo etike ta them tash le të më dëgjojnë të gjithë nëse dikush e merr mandatin për vlerësimin e fjalive të mia thash diqka apo nuk thash diqka për shkak se unë ende nuk kam angazhuar as ndonjë institut ndonjë mjek ose ndonjë psikolog për te cilin duhet te vlerësojnë fjalimet e mia është vitit I 4-të nuk ka rast që ndodh që te flas me u jap fjala dhe kështu që kisha kërkuar me mirkuptim për shkak edhe te natyrës që e kam kusdo koft let rezervohen gjat fjalimeve që unë I bëjë, të jemi te kujdesshëm sa I perket pikes së dytë unë e di që nuk ke mekanizëm të detyrues se keto deklarimet jasht rendit të ditës të bëhen në fillim të séances me qenë se unë e kuptoj që kryetari mund te ket agjenta por jo secili drejtor po besoj që për shkak te detyrës që I kan dhe për shkak te rrespektit ndaj neve është dashur te jenë present në shpesh here kemi pika te cilat na ngrisin qytetarët ose kërkesave na perveq te drejtorit të bujqësis kemi problem si shperfaqim unë e kam një kërkesë përshembull të qytetarëve nga Isniqi për sa I takon pengesave në rrugën e fshatit e di që keto janë të bezdishme në raport me shoferët po me qenëse edhe shoferët të tjerë të cilët nuk I rrespektojnë normat ose rregullat në komunikacion është njëfar mekanizmi që polic të shtrir apo siq quhen në gjuhen e komunikacionit, para 10 ditëve në lagjen (...) vetem që ka qenë kohë jo frekuentueme se po te kishte ndodh në oret e dites aty ka mundur me pas edhe viktimë me qenë se... ekspertet e përcaktojnë se ku është e nevojshme po ta kenë parasysh vendosjen e pengesave për gjat rrugës në fshatin Isniq faleminderit.

## Hajdar Sutaj

Faleminderit Miftar, realisht sa I perket shqetsimit që e ngriti për dicitimin e anetarve te kuvendit është e domosdoshme që te tregojnë rrespekt gjatë komunikimit po edhe gjat diskutimit te kujdo dhe ishte dashur mos te kem as unë as kusdo ndonje nderhyrje në kete drejtim por gjithsecili, edhe gjat séances anetarët e kuvendit mundën me leviz kohë pas kohe me dal me diskutu diqka edhe jasht kishte me qenë mirkuptim e dyta sa I perket egzekutivit ish dashur me qendru sikurse po qendrojmë në jo vetëm vrejte e jotja le te mbetet edhe vërejtja e imja dhe e falenderoj edhe drejtorin Rifatin këtu që është domethanë pat e spat pika rrin deri në fund ish dashur me qenë model e kuptojnë që ndonje seancë ndokush smundet me marr pjesë ndonjeher nuk mundemi me marr pjesë as në është normale mundemi me pas obligime të ndryshme familjare, shoqerore ose shëndetsore kështu, tjetra sa I perket pengesave e kemi pasur edhe një ditë diskutim veç shkurtimisht me thanë që me të vërtetë janë duke kërkuar pengesa shumë edhe pengesa me ba, gjithë kush është duke kërkuar pengesa, të gjithë gjysma e Deçanit para shtepis se vet kerkojnë pengesa duhet me u bazu në raportin e policis duhet mu bazu në raportin e inspektoriatit te komunikacionit, nëse kisha pasur me jap mendimin tim vetëm

afër shkollav edhe ne udhëkryqje janë shumë të rrezikshme ku është konstatuar do të thotë që ka pasur aksidente shumë për ndryshe polivia duhet të bëjë punën e tyre shejat e komunikacionit duhet rrespektuar, shoferët duhet të kenë kujdes sepse aksidentet mund të ndodhin edhe në autostrada, e ka kerkuar fjalën Syl Balaj pastaj Vatani pastaj Albesa

### **Sylë Balaj**

Atëhere përshëndetje për të gjithë kisha shumë pyetje po po shihet kjo eshte radha e 4 a 5 skemi kujt ti bejme pyetej vetëm drejtorit te bujqësis tv cilin e përgëzojm, kisha shumë pyetje por kisha edhe per drejtoreshen per kultur rini dhe sport deri tash ishte tani se pa te arsyeshme me qëndru na la, na e lame që te pikat e te të ndryshmeve ti bëjmë pyetje drejtoreshes ajo se pa te arsyeshme te qendroj, jo ti vet l the po e lëjmë për fund tek pikat e te të ndryshmeve ajo shkoj, vetëm desha ti thoja a ka qenë ajo ndonjëher ti vizitoh klubet sportive të Deçanit ku dihet vështirësia e madhe financiare sidomos tek klubi i futbollit ku me gjith ato vështirësi ka arrit edhe të mbijetoj në ligë ti përgëzojm për punën besoj se radhën tjetër te mobilozohen me shum te l subvencionojn dhe te kaloj ne ligë më lart ku dihet se jemi ne liga te fundit te futbollit faleminderit.

### **Hajdar Sutaj**

Faleminderit Syl, Vatan Istrefaj.

### **Vatan Istrefaj**

Faleminderit për fjalën kryesus përshëndetje për të gjithë arsyeja pse jam këtu kryesus nuk është për postim por vetëm për të parë edhe qytetarët të cilët na përcjellin gjendjen e séances komunale ku tani jemi tek pika e të ndryshmeve është koha që ne si përfaqësues te lokaliteni jon ne Deçan ti bëjmë pyetje dhe kerkesat tona dhe siq e shohim pothuajse askush nga egzekutivi komunal këtu nuk është present me ne, ne si asambleist kemi shumë kërkesa nga qytetarët të cilët kemi komunikim të vazhdueshëm me ta po nuk kemi ku ti adresojm ato ne kuvendin komunal pra kjo është shumë për keqardhje pasi që kërkesat tona janë të ndryshme përshembull në infrastruktur tani më jemi duke u afruar në sezonin verës dhe shumë fshatra nuk kan as ujë të pijes a ka komuna ndonje plan për ujësjellsin në komunën e Deçanit saktësisht në shumë fshatra të cilat kanë munges poashtu në infrastrukturën rrugore përshembull në fshatin Prelep është rruga kryesore që lidh fshatin Prelep me Dranovc është rruga në gjendje të mjerushme pasi që aty është intervenuar në rrjetin e kanalizimit që një kohë të gjatë dhe nuk po bëhet mirëmbajtja e asaj rruge perpros tjerash kam nje kerkes ne qendren e fshatrit Strells tash e dy muaj per mirëmbajtjen e hyrjes së fshatit ku jan shkaktuar disa probleme apo te themi gropa në atë pjes ku shumë vetura po rrezikohen per mirëmbajtjen e tyre ku qytetarët mund te shfaqin ndonjë aksident kohë pas kohe per shkak te mos kujdesit nga menaxheri l kontrates qe e ka per mirëmbajten e rrugëve pra edhe njëherë presim që komuna e Deçanit të reflektoj dhe zakonisht tek pika e te të ndryshmeve ku ne kemi bere pyetje të qëndrojn dhe të ballafaqoheni me ne pasi që ne jemi perfaqësues të popullit dhe kjo është detyrë e jona faleminderit .

### **Hajdar Sutaj**

Faleminderit edhe juve faleminderit shumë, Albesa Cacaj e ka fjalën.

### **Albesa Cacaj**

Ka dy mbledhje që ose dy muj sa l qesh që unë paraqes të njëjtën kërkesë edhe të marr përgjigje, qoftë nga kryetari ose drejtorët përkatës. Po, mendoj që i takon kryetares të përgjigjet në kërkesën ose pytjen që kam parastruar para dy mujve, që në këtë sezon të bjen para tre mujve. Ka të bëjë me raportin e veprimeve që ka ndërmarrë komuna lidhur me veprimet për shqyrtimin e rekomandimeve nga auditori jashtëm. Pra, komuna e ka obligim ligjor të paraqes një plan të veprimit, ku paraqitet mënyra se si janë zbatuar rekomandimet e dhëna. Mirpo, komuna nuk ka raportu me kohë lidhur me zbatimin e rekomandimeve përmes raporte periodike të zbatimit, të cilat do duhej të dorëzoheshin me 30 qershor 2024 dhe me 15 mars 2025. Kështu që kam kërku përgjigje me ardhë edhe me na tregu kryetares pse nuk nuk ka ndërmarrë ky veprim deri me tani, sepse tani shpejt e kem edhe raportin audio auditorit të jashtëm, që jep kualifikim për komunën e Deçanit. Faleminderit.

## Hajdar Sutaj

Faleminderit edhe juve.

Gjithsesi mbetet edhe e inqizuar edhe në transkript, krejt ajo që ke thonë edhe ti dhe koleget tjera, pavarësisht a kanë qenë të prezent pergjegjs, për pyetjet që ju keni drejtuar. A ka dikush tjetër ndonjë pyetje? Po zotri Mon Selmanaj fjala per ju.

## Mon Selmanaj

Duke i parashtruar pytjet dul edhe ajo tash le te mbeten këtu I kam tri çashtje, tri pyetje, për të cilat. Po falimnderit. I kom tri pyetje, për të cilat deshta t'i parashtrojë drejtoreshes. pas mungesës se kryetarit kuptohet.

E para është që tri vjet ne e kemi miratuar në Kuvend trotuarin prej shkollës së Rastavicës deri ne lagjen e Mullive është bart vit pas viti ne buxhet Deshta me ja parashtu pytjen se a pritet fillimi i atyre punimeve tash apo kur fillojnë fushata ose nuk po di.

Tjetra është procedura e ndertimit të urës së fshatit dhe 100 metra rrugë, për të cilat janë shumë te rrezikuara e kanë parë edhe inzhinerat e Komisionit që kan dal herë pas here, edhe ajo që dy tri vjet eshte duke u zhagitur jo sot po nesër, kështu që deshta të marr mendimin edhe për kendin e lojrave, për të cilin edhe ky që tri vjet është ka zhagitet jo këtë vit, jo tjetrin dhe këto tri qeshtje, këto tri qashtje deshta me i parashtu po le te mbeten si po thu ti te shkrome dhe I kthejm prej djellit faleminderit

## Hajdar Sutaj

Faleminderit zotri Mon kerkcesat te cilat ju I ngritet sigurisht do te realizohen tash duke u afruar nga zgjedhjet edhe ura edhe trotuaret edhe kandi I lojrave

## Mon Selmanaj

Nuk eshte mir me I lan 3 vjet dhe me I pru ne prag te zgjedhjev keshtu tani o iritohen votuesit megjithate ndertoni hiq mos keni dert

## Hajdar Sutaj

Me qenë se ju jeni nga fshati Restovic edhe Fatoni po ashtu, na me të vërtet jemi krenar me punën që e bëni si fshat dhe këshilli I fshatit jeni shembull edhe mirëmbajtjen e ambientit hapsirave publike pastertin kujdesin, varrezat, shkollën, odën e fshatit shumë të tjera me të vërtet jeni shembull, të gjith kryetarët e fshatrav I kisha ftuar në takim aty te ju me e pa, edhe punët edhe investimet per fat të mirë skan pasur të ndalur edhe do vazhdojnë të jenë, kështu që ju përgëzojm, a ka dikush tjetër diqka.

Kolegë, ju falenderoj shumë për kontributin që e dhatë në këtë mbedhje dhe ju falenderoj shumë për durimin dhe mirkuptimin le të jetë një sygjerim në radhë të parë për anëtarët e kuvendit që kanë munguar pa ndonjë aryse të madhe që me qenë pjesë në këto seanca të cilat janë te fundit gati nga mandati e mbi të gjitha le të jetë një kërkes për egzekutivin e komunës që të jenë të pranishëm ata që nuk munden të paktën 70%-80% munden me qenë e ata që nuk munden ta tregoj arsyen qe nuk munden edhe pergjigjen herav të tjera, me kaq e mbylli këtë seancë mirë u takofshim në seancat e tjera.